Ky shërbim ka për qëllim rritjen e cilësisë së komunikimit publik, forcimin e transparencës institucionale, si dhe rritjen e ndërveprimit me qytetarët dhe palët e interesuara. Nëpërmjet këtij shërbimi synohet gjithashtu promovimi më efektiv i potencialeve turistike dhe aktiviteteve të zhvilluara nga Bashkia Librazhd, në përputhje me standardet bashkëkohore të komunikimit publik.
Shërbimi përfshin hartimin e strategjive të komunikimit, menaxhimin profesional të përmbajtjes në rrjetet sociale, si dhe ofrimin për përmirësimin e imazhit dhe prezencës institucionale në median online.
Vlera e realizimit të këtij shërbimi është 500,000 (peseqind mijë) lekë me TVSH.

Ky relacion hartohet për të shoqëruar dokumentacionin përkatës dhe për të pasqyruar nevojën dhe rëndësinë e realizimit të këtij shërbimi për institucionin.

***Konceptoi:*** Imelda Sina

**Objekti: Mirëmbajtje dhe Menaxhim Rrjetesh Sociale**

**Përshkrimi i shërbimit**

| Nr | Përshkrimi i shërbimit | Njësia | Sasia | Vlera (lekë) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Krijimi i strategjisë së komunikimit digjital dhe kalendarit mujor editorial | Paketë | 1 | 50,000 |
| 2 | Menaxhim i faqeve Facebook, Instagram, dhe LinkedIn, Postime ne faqe pa limit (postime, përmbajtje vizuale e tekstuale, komunikim me ndjekësit) | Muaj | 12 | 300,000 |
| 3 | Krijim materialesh vizuale: foto, video të shkurtra, dizajne grafike profesionale për postime | Paketë mujore | 12 | 90,000 |
| 4 | Promovime me pagesë (Ads Management) – planifikim, optimizim dhe raportim i fushatave | Paketë | 1 | 40,000 |
| 5 | Raport mujor i performancës dhe rekomandime | Paketë | 1 | 20,000 |
| | **Totali:** | | | **500,000 lekë** |

Bajram Pishkashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

P/V
Nº=5

BASHKIA LIBRAZHD

KRYETARI

P/ VENDIM

NR ____ DATE ___/03/2026

" PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE "

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore " neni 54 pika dh ,të Ligjit 68/2017 "Për Financat e Vetqeverisjes Vendore ",të Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" , si dhe ne udhezimin nr. 9 date 20.03.2018 " Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë ____/03/2026 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd

VENDOSI :

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare per Z.Hajdar Balla nga fshati Babje Njësia Administrative Qender si familje ne veshtiresi ekonomike. në vlerën 500, 000 lekë.
2. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare për Z.Avni Duka nga fshati Dardhë Njësia Administrative Hotolisht si familje në vështiresi ekonomike në vlerën 100, 000 lekë.
3. Fondi prej 600,000 lekë do të përballohet nga fondi i miratuar në buxhetin e Bashkisë Librazhd për vitin 2026 "Ndihmë Financiare " në strukturën buxhetore si më poshtë:

| Grupi | titulli | kapitulli | artikulli | vlera | |
|---|---|---|---|---|---|
| 0 0 | 1110 | 0 1 | 606 | 600,000 lekë | ndihme financiare |

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit,Menaxhimit Financiar, Sektori Financës .

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

**KRYETARI I BASHKISE**
**MARIGLEN DISHA**

Adresa: Sheshi " Gjorg Golemi" www.bashkialibrazhd.gov.al, info@bashkialibrazhd.gov.al

#Financa / 18.02.2026

1004

Dt 17.02.2026

KËRKESË/ANKESË

Drejtuar Bashkisë Librazhd

DATË :___/___/2026

Drejtorisë së ........................................

Unë i/e nënshkruari/a ...Hajdar Balla........ banues në.......Babje.......................

Kërkoj nga ana e Bashkisë Librazhd drejtorisë suaj zgjidhjen e problemit tim i cili është si më poshtë:

Për shkak të vështirsisë ekonomike kerkoj nga Bashkia një ndihmë ekonomike sepse vuaj nga një semundje dhe jam berë operacion për transplant veshkash. Ky operacion kushtoi shume dhe tani nuk kam më asnje të ardhur për të jetuar dhe për ti siguruar femijeve. Nesë e keni të mundur ta merrni parasysh kerkesin time sa më shpejt.

Ju faleminderit,

Shpresoj që kërkesa ime të meret parasysh nga ana e drejtorisë përkatëse!

Nr.Tel : 0673963542

Nënshkrimi:

Hajdar Balla

(emër,mbiemër,firmë)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

BASHKIA LIBRAZHD

NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER

**Njesia Administrative Qender Librazhd Rruga“ Stacioni i trenit” Librazhdtel. 0694442014**

**Nr. 155 Prot.** **Librazhd, me:20.02.2026**

**Lënda: Relacion mbi gjendjen e familjes Z:Hajdar Destan Balla**

**Drejtuar :Bashkisë Librazhd .**

Në lidhje me rastin e familjes në fjalë, **Z:Hajdar Destan Balla** me verifikimin e bëre në shtëpi më datë 16.02.2025 ne fshatin Babje ,kjo familje rezulton ne kushte shume të vështira social-ekonomike.Kjo Familje përbëhet nga 4 anëtare.Te dy Kryefamiljaret të papunë,Hajdari trajtohet me pagesë aftësi e kufizuar dhe ndihma ekonomike e kane ndihmuar te perballoj shpenzimet qe ka kryer per trajtimin e semundjes nga e cila vuan prej viteve te lindjes por se fundmi i eshte lidhur pagesa e paaftesise . Të ardhura te tjera qe kishin jane ato që arrinin të fitonin nga blegtoria e bujqësia këto të ardhura nuk i mjaftojnë per të perballuar as shpenzimet minimale jetësore ,fëmijët janë në moshë minorene për këtë arsye bashkëshortja nuk mund te gjej një punë.Duke u bazuar ne situaten social ekonomike Zyra e ndihmes ekonomike e vlerson si familje per tu referuar te mbahet ne konsiderate per cfardo lloji ndihme qe jepet nga Njesia Jone apo Bashkia Librazhd .

Faleminderit për Bashkepunimin !

**Konceptoi :**

**P.ZNDIHMES EKONOMIKE** **Administratori**

**Elida KARAJ** **Roland ÇOTA**

Adresa: "RrugaStacioni I trenitLibrazhd" Email: Fjoralbacapja50@gmail.com Nr.tel 069444201

REPUBLIKA E SHQIPERISE



mbiemri/surname
**Balla**
emri/given name
Hajdar
shtetësia/nationality
Shqiptare/Albanian
vendlindja/place of birth
Babje, ALB
datelindja/date of birth
16-02-1993
data e lëshimit/date of issue
05-01-2022
autoriteti lëshues/authority
MPB

nr. letërnjoftim/card no.
038015123



gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
**04-01-2032**
nr. personal/personal no.
**J30216020U**

firma/signature

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**Bashkia** Librazhd

**Njësia administrative** Qendër Librazhd

**Zyra e Gjendjes Civile** 144

Datë: 11.02.2026

# CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

| Nr. | Emri e Mbiemri | Emri i Babait | Emri i Nënës | Gjinia | Lidhja me K. Familjarin | Datëlindja | Gjendja Civile | Vendlindja | Shtetësia | Numri Personal |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Hajdar BALLA | Destan | Dhurata | M | Kryefamiljar | 16-02-1993 | I/e martuar | Babje, Librazhd | Shqiptare | J30216020U |
| 2. | Brunilda BALLA | Bashkim | Drita | F | Bashkëshorte | 09-12-2000 | I/e martuar | Librazhd | Shqiptare | K06209020S |
| 3. | Enis BALLA | Hajdar | Brunilda | M | I Biri | 26-11-2020 | Beqar/e | Librazhd | Shqiptare | M01126035B |
| 4. | Sean BALLA | Hajdar | Brunilda | M | I Biri | 12-05-2022 | Beqar/e | Librazhd | Shqiptare | M20512015V |
| 5. | Elja BALLA | Hajdar | Brunilda | F | E Bija | 15-12-2023 | Beqar/e | Librazhd | Shqiptare | M36215012Q |
| 6. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 7. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 8. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 9. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 10. | ----------------- | | | | | | | | | |

Kjo certifikatë lëshohet për ______________________________

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date:2026/02/11 09:34:56 +02'00'
31f9e242c0f0454da9582f12ab9e81752

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)*

K. Bashkiak [signature] 18.03.2026

KERKESË

1613

Dt 18.03.2026

UNË I NËNSHKRUARI AVNI DUKA BANUES NE FSHATIN DARDHE NJËSIA ADMINISTRATIVE HOTOLISHT, BASHKIA LIBRAZHD. KERKOJ NGA ANA E BASHKIS LIBRAZHD DHE KËSHILLI BASHKIAK TË MË NDIMOJ FINANCIARISHT PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVË TË VARRIMIT. PËR JATKERJIN QË ME NDODHI QË DJALI I IM LEONARD DUKA HUMBI JETEN ME DATË 15.02.2026. PASI FAMILJA I MË JËTON NË KUSHTË TË VËSHTIRA ËKONOMIKE.

DUKË SHPRESUAR QE KERKESA IME DO MERRET PARASYSH.

ME RESPËKT

AVNI DUKA

[signature]

# Radiology Examination Report / Raport i Ekzaminimit Radiologjik

| | | | |
|---|---|---|---|
| Patient / Pacienti: | HAJDAR BALLA | Order Ref. / Numri i Kerkeses: | 2014/RAD000056192 |
| Reference / Kodi: | 320399 | Order Date / Data e Kerkeses: | 26/12/2014 12.30.50 |
| Sex / Gjinia: | M | Approve Date / Data e Aprovimit: | 26/12/2014 15.03.53 |
| Birthday / Datelindja: | 1993-02-16 | | |

## EKOGRAFI DOPLER E SISTEMIT ARTERIAL TE ANESIVE INFERIORE

Arteriet iliake eksterne, arteriet femorale komune, arteriet femorale superficiale, arteriet femorale profunda, arteriet popliteale bilaterale me lumen te hapur dhe kalueshmeri te lire. Arteriet me kaliber normal te lumenit, pa evidence pllake aterosklerotike apo stenoze luminale te rendesishme.Te gjithe segmentet me shpejtesi maksimale te fluksit (PSV) brenda kufijve normal.

Arteriet tibiale anteriore, tibiale posteriore, peroneale dhe arteriet dorsalis pedis bilaterale me lumen te hapur dhe kalueshmeri te lire. Arteriet me kaliber normal te lumenit, pa evidence pllake aterosklerotike apo stenoze luminale te rendesishme. Te gjithe segmentet me shpejtesi maksimale te fluksit (PSV) brenda kufijve normal.

**Conclusion / Konkluzioni :**

**- Ekzaminim normal i sistemit arterial te anesive te poshtme.**

**Dr. ALBANA SHAHINI**
**Radiologe**

2946

Referimi elektronik

## Pacienti

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nid : | J30216020U | Atesia : | Destan | Kategoria : | Semundje Kronike |
| Emri : | Hajdar | Gjinia : | Mashkull | Mjeku Familjes: | Arlind Kullolli |
| Mbiemri : | Balla | Datelindja : | 16.02.1993 | Qsh: | Qender Librazhd |

## Rekomandimi i mjekut te familjes

Nr. Rekomandimi : 561  Dt. Rekomandimi 15.08.2024  Diagnoza : Pa percaktuar

Motivi i rekomandimit:

Vizite Kontrolli per KMCAP

Ekzaminimet :

Problemet :

Trajtimet :

Dt: 16-8-2024

Nr. reg: 314

## Rezervimi i rekomandimit

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Institucioni i referauar : | Poliklinika e Specialiteteve Elbasan | Dita : | 16.08.2024 | Radha : | 14 |
| Specialiteti : | Nefrolog | Fasha : | 08-10 | | |

## Percaktimi i mjekut specialist

Nr 1580

Mjeku specialist : Everest Hoxha

Dr. Everest Hoxha
Nefrolog Q. Spita
Elbasan

Nr 1580

- Myfortic 180 mg 2x1 60 tb
- Tacrolim 1 mg 2x1 60 tb
- Mycophenolic acid 360 mg 2x1 60 tb
- Prednison 30 tb

REPUBLIKA E SHQIPERISE
POLIKLINIKA E SPECIALITETEVE
ELBASAN

Qendra Spitalore Universitare
"NËNË TEREZA"
SPITALI 1,2,

PROF. ALMA IDRIZI
NEFROLOGE
NËNË TEREZA

Spitali Amerikan
www.spitaliamerikan.com

LAPRAKË
042 35 75 35 24h
Rruga "Lord Bajron" / Tiranë
pranë S.U.Q.U, Laprakë

RR. DIBRËS
042 36 66 63 24h
Rruga e Dibrës / Tiranë
pranë Fakultetit të Mjekësisë

# Radiology Examination Report / Raport i Ekzaminimit Radiologjik

| | | | |
|---|---|---|---|
| Patient / Pacienti: | **HAJDAR BALLA** | Order Ref. / Numri i Kerkeses: | 2014/RAD000056693 |
| Reference / Kodi: | 320399 | Order Date / Data e Kerkeses: | 31/12/2014 10.55.29 |
| Sex / Gjinia: | M | Approve Date / Data e Aprovimit: | 31/12/2014 11.29.31 |
| Birthday / Datelindja: | 1993-02-16 | | |

## EKOGRAFI DOPPLER E RENIT TRANSPLANT

Reni transplantur me vendosje ne fosa iliaka sinister.
Reni i transplantuar me dimensione 10.8 x 4 cm, me trashesi parenkimale 15 mm, me indeks kortiko-medular te ruajtur.Pa zgjerim te sistemit pielokalicien.

Ne hilusin renal evidentohet fluks ne arterien dhe venen renale.
Shpejtesia e pikut sistolik ne arterien renale 110 cm/s me RI=0,66-0.73 , ne urificiium me PS ne kufirin maximal (150 cm/s ) me dalje ne forme harku kendore te arteries renale nga arteria iliake .
Shpejtesia e pikut sistolik ne arterien iliake eksterne 135 cm/s.
PSV RA/PSV EIA eshte normale,<3.

Ne analizen e spektrumeve te arterieve arkuate te marra nga poli inferior,superior dhe zonat e mesme te reneve bilaterale evidentohen shpejtesi dhe forme fluksi normale.Vlera normale te RI.

Prezence e kateterit (double g) ne pielon dhe ne veziken urinare.

Nuk evidentohet likid i lire ne fosa iliaka dextra.

**Conclusion / Konkluzioni :**

**- Pamje normale e permasave dhe e struktures me vlera normale .**
**- PS ne kufirin maximal dhe shtrirje harkore e daljes e arteries renale .**

American Hospital
ADRIATIK DAKU
Radiolog Imazherist
Licenses 6304

**Dr Adriatik DAKU**
**Radiolog**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBRAZHD**

**NJËSIA ADMINISTRATIVE HOTOLISHT**

**Nr.** 151 **Prot.** **Hotolisht më,** 18.03.**2026**

## Relacion

Bazuar në verifikimi e kryer   në familjen e Z,Avni Xhemal Duka  , banues në fshatin Dardhe Njësia Administrative Hotolisht,Bashkia Librazhd ,rezulton se  Z Avni  jeton ne kushte të veshtira ekonomike,banesa eshte e përshtatshme,  Famija përbëhet nga 4  anëtarë Z ,Avni bashkëshortja e tij Znj,Valbona dhe dy djemtë  e tij  Mariglen dhe Sajmir Duka as njeri prej tyre nuk është i punësuar. Bashkeshortja e tij Znj,Valbona Duka ka dhe probleme shëndetesore Fatekeqesisht Z,Avni i ka ndrruar jete djali i tij i madhi 23 vjeç i ndjeri Leonard Duka  më dt 15.02.2026  kjo e bën akoma dhe me te rënde  situaten e kësaj familje.

**SP/NDIHMES EKONOMIKE**

**Ardian Poçi**

**ADMINISTRATORI I NJESISE**

**Klodian DAJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - NJËSIA ADMINISTRATIVE HOTOLISHT - BASHKIA LIBRAZHD

LETËRNJOFTIM ID REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA




mbiemri/surname
**Duka**
emri/given name
Avni
shtetësia/nationality
Shqiptare/Albanian
vendlindja/place of birth
Dardhë, ALB
datelindja/date of birth
01-05-1980
data e lëshimit/date of issue
05-04-2019
autoriteti lëshues/authority
MPB

firma/signature
AVNI DUKA

nr. letërnjoftim/card no.
034106271



gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
**04-04-2029**
nr. personal/personal no.
**I00501031L**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Bashkia** Librazhd
**Njësia administrative** Hotolisht
**Zyra e Gjendjes Civile** 140

Datë: 18.03.2026

# CERTIFIKATË VDEKJE (NGA AKTI)

Në bazë të aktit të vdekjes nr. 45 datë 26.02.2026 vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

| Përbërës të Gjendjes Civile | |
|---|---|
| Emri | Leonard |
| Mbiemri | DUKA |
| Numri Personal | K21111015E |
| Emri i Babait | Avni |
| Emri i Nënës | Valbona |
| Datëlindja | 11-11-2002 (zero dy) |
| Vendlindja | Librazhd |
| Vendbanimi | URA E POLISIT; Nd. 48; H. 1; HOTOLISHT; DARDHË; 3408; LIBRAZHD |
| Gjinia | Mashkull |
| Gjendja Civile | Beqar/e |
| Shtetësia | Shqiptare |
| Data e vdekjes | 15-02-2026 |
| Vendi i vdekjes | Servis |
| Shkaku i vdekjes | Aksident i shkaktuar nga veglat në servis |

Kjo certifikatë lëshohet për ______________________

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date:2026/03/18 10:47:31 +02'00'
7dc7bfb1a8c84d49b99b447724a2c3d1

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

1/U
nr = 6

P/VENDIM

NR ____ DATË /___ /2026

"PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PROJEKTEVE PRIORITARE NË INFRASTRUKTURËN E BASHKISË LIBRAZHD PER PROJEKT BUXHETIN AFATMESEM VITIN 2027-2029"

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore "neni 54 pika të Ligjit 68/2017 "Për Financat e Vetqeverisjes Vendore ", Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe në udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimi Nr.7 datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029", Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë __/03/2026 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

**VENDOSI:**

I. Të miratojë listën e projekteve prioritare në infrastrukturën të Bashkisë Librazhd për vitin 2027-2029 sipas tabelës bashkangjitur.

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Punëve Publike, Drejtoria e Buqësisë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe Pronës, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Buxhetit Menaxhimit Financiar dhe Shërbimi Social.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI BASHKISE
**Mariglen Disha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, KONTROLLIT TË TERRITORIT DHE PRONËS
SEKTORI I PROJEKTEVE

**Lista e Investimeve Prioritare ne infrastrukturen e bashkise Librazhd per vitin 2027-2029**

| Nr. | Emertimi i Objektit | Vlera (leke me t.vsh) |
|---|---|---|
| 1. | Rikonstruksion i rrugeve rurale te Bashkise Librazhd | 20,000,000 |
| 2. | Sistemim asfaltim rruga e Shes, Bashkia Librazhd | 34,535,435.90 |
| 3. | Sistemim asfaltim rruga e shkolles, Mirake-Gjovac, Bashkia Librazhd | 24,867,153.51 |
| 4. | Sistemim, asfaltim i rruges 10 Nentori (Varrezat e Dëshmoreve), Bashkia Librazhd | 36,957,473.44 |
| 5. | Rikonstruksioni i rruges Fshati Kokreve, Loti II, Bashkia Librazhd | 61,431,764.42 |
| 6. | Sistemim asfaltim i rruges Fshati Spatharë (Loti II), Bashkia Librazhd | 25,405,826.67 |
| 7. | Rikonstruksioni i rruges se Zallit Zdrajsh Verri-Floq, Faza I, Njësia Adm. Orenjë, Bashkia Librazhd | 123,646,987.79 |
| 8. | Rikualifikim urban Blloku banimit nr. 3 (Lagje Stacioni I Trenit), qyteti Librazhd | 210,494,443 |
| 9. | Asfaltim I rruges se fshatit Arrez, Njesia adm Qender | 100,531,861 |
| 10. | Rikonstruksion te segmentit rrugore te lagjes Dod-Kove Rrapi- shpia e Karajt | 50,000,000 |
| 11. | Rikonstruksion te segmentit rrugore lagjia Isenaj, lagja Shpata | 50.000.000 |
| 12. | Rikonstruksion te segmentit rrugore qe lidh lagjen Troshku me fshatin Zgosht | 50,000,000 |
| 13. | Rikonstruksion i segmentit rrugor (Botore –Shpatadoll – Llanga) fshati Letem | 120,000,000 |
| 14. | Asfaltim i segmentit rrugor Zgosht – fshati Letem | 40.000.000 |

| | | |
|---|---|---|
| 15. | Asfaltim i rruges “Maksut Kenga” dhe rruges se “Mojsjes” ne qytetin Librazhd | 12.000.000 |
| 16. | Asfaltim i rrugës së fshatit Drabata Hotolisht, bashkia Librazhd | 25.000.000 |
| 17. | Asfaltim i rrugëve në qytetin Librazhd | 50.000.000 |
| 18. | Ndërtimi i qendrave të fshatrave të njësive administrative | 60.000.000 |
| 19. | Mbrojtja e tokës bujqësore | 10,000,000 |
| 20. | Riparimet ë pjesshme në kanalet vaditëse Njësia Adm Hotolisht, Nj.Adm. Polis, Nj.Adm. Orenjë, Nj.Adm. Qendër, Nj.Adm. Lunik | 10,000,000 |
| 21. | Rikonstruksion Fasadat e qytetit + Çati | 50,000,000 |
| 22. | Rikonstruksion teresor dhe ndertimi i palestres se shkolles se bashkuar Orenje | 82,700,474 |
| 23. | Rikonstruksion i cerdhes se qytetit | 35,326,392 |
| 24. | “Riparimi i digave ekzistuese te liqeneve akullnajore nr.1 dhe nr.2 Kusar" dhe "Rikonstruksion i kanalit te malit Kusar - Fushe Studen - Letem", faza 1 njesia administrative Stëblevë | 175,020,156 |
| 25. | Rikonstruksion i Muzeut Etnografik | 35,760,221 |
| 26. | Ndërtim i Poliklinikës së re në qytetin Librazhd | 73,000,000 |
| 27. | Mbrojtja lumore e zones perendimore te qytetit Faza III | 77,192,544 |
| 28. | Blerje paisje elektronike | 500,000 |
| 29. | Hidroizolimi I shkollave dhe institucioneve | 5,000,000 |
| 30. | Blerje tuba per kanalet vaditese | 2,400,000 |
| 31. | Ndërtim nga e para e Zjarrëfikses Bashkia Librazhd | 50.000.000 |
| 32. | Rehabilitimi i shtatit të lumit Shkumbin përgjatë pritës lumore | 20.000.000 |
| 33. | Urë Tip Baily Qarrishtë | 12.000.000 |
| 34. | Sistemim asfaltim rruga Xhyre Qender- Xhyre Mal | 188,295,413 |

KRYETARI BASHKISE

p. **Mariglen Disha**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BASHKIA LIBRAZHD**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, KONTROLLIT TË TERRITORIT DHE PRONËS**

# RELACION

## MBI LISTEN E PROJEKTEVE PRIORITARE NE INFRASTRUKTUREN E BASHKISE LIBRAZHD

Në bazë të udhëzimit Nr. 7 datë 27.02.2026 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029" dhe në kuader te permiresimit te infrastruktures rrugore rurale te Bashkise Librazhd,zhvillimit urban, kerkesat e banoreve dhe kerkesat e administratoreve te njesive administrative jane evidentuar objektet per investime prioritare si me poshte:

1. ***Sistemim – Asfaltim i Rrugës së Shese***

Rruga e Shese ndodhet ne juglindje te qytetit Librazhd dhe eshte e vetmja rruge qe lidh zonen qendrore te qytetit me lagjen e Podes dhe te fushes se Dragostunjes. Gjate permbytjeve nga vershimi i perroit te Shese, pati rreshqitje te dheut çka solli demtimin e rruges, Ky investim eshte i domosdoshem. Infrastruktura është e degraduar: shtresa e vjetër është e çarë, e dëmtuar, me gropa të shumta dhe me probleme në drenazhimin e ujërave të bardha. Në ditë me reshje, rruga krijon ujëmbledhje, baltë dhe rrëshqitje, duke e bërë qarkullimin të vështirë për këmbësorët dhe automjetet. Rruga në fjalë propozohet të trajtohet me gjerësi të trupit të rrugës (pjesës kaluese) 3.5 m (shtresë asfaltike), në mënyrë të tillë që të lejojnë qarkullimin normal të mjeteve të emergjencës bankina nga 0.5m në të nje anët e rrugës dhe kunete 0.5 m ne tjetren. Të parashikohet mundësia e zgjerimit në varësi të rëndësisë dhe të hapësirës. Në rastet kur nuk është e mundur zgjerimi i rrugës, të ruhet gjerësia e saj sipas gjurmës ekzistuese.

2. ***Sistemim – Asfaltim i Rrugës së shkollës Mirakë-Gjovaç, Bashkia Librazhd***

Rruga e fshatit për te shkolla eshte ne gjendje teper te amortizuar, nuk ka shtesa asfaltike, eshte e pa asfaltuar. Mungesa e sistemimit te ujrave atmosferike eshte bere problem per banoret. Gjate inspektimit kemi degjuar ankesat e banoreve per gjendjen ne te cilen ndodhet rruga. Gjatë ditëve me shi balta është prezente në rrugë, gjë që bën te vështirë kalimin në këmbë te banoreve si dhe te mjeteve. Gjatë ditëve me diell dhe me mot të thatë prezenca e pluhurit është përetj kufijve të lejuar të ndotjes.

3. ***Sistemim, asfaltim i rrugës 10 Nëntori, Bashkia Librazhd***

Zona ku parashikohet të bëhet investimi është zonë e banuar, dhe vendoset në një zonë disi periferike të qytetit të Librazhdit. Kjo rrugë ndodhet 800m larg qendrës së qytetit të Librazhdit. Aktualisht eshte i nevojshem sistemim asfaltimi i rruges 10 Nëntori pasi shtresa e vjetër është e çarë, e dëmtuar, me gropa të shumta dhe me probleme në drenazhimin e ujërave të bardha. Në ditë me reshje, rruga krijon ujëmbledhje, baltë dhe rrëshqitje, duke e bërë qarkullimin të vështirë për këmbësorët dhe automjetet

4. ***Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Kokreve faza II Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd***

Rruga ekzistuese që lidh fshatin Kokreve me rrugën kryesore është në kushte të vështira, duke krijuar vështirësi për qarkullimin e automjeteve dhe duke ndikuar negativisht në zhvillimin e zonës. Kjo rrugë është e papërshtatshme për kalimin e mjeteve të transportit, sidomos gjatë periudhave të reshjeve të shiut dhe dimrit, ku krijohen baltë dhe ujëra të grumbulluara.

Në këtë kontekst, asfaltimi i kësaj rruge do të:

- Përmirësojë cilësinë e transportit dhe qarkullimin e mjeteve.
- Lehtësojë aksesin e banorëve të fshatit dhe atyre të zonave përreth në qytetet më të mëdha.
- Ndihmojë në zhvillimin e turizmit, bujqësisë dhe tregtisë në zonë.

5. ***Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Spathar Loti II, Njësia Adm.Qendër, Bashkia Librazhd***

Ky segment rrugor fillon nga Xhamia Spatharit dhe eshte e gjate 680 ml. Infrastruktura rrugore ekzistuese në këtë segment është në gjendjë të amortizuar për shkak të viteve dhe mirëmbajtjes së ulët. E gjithë gjatësia e rrugës është me zhavor por faktorët atmosferikë kanë sjellë deformimin e trupit të rrugës. Rruga në fjalë propozohet të trajtohet me gjerësi të trupit të rrugës 3.5 m (shtresë asfaltike), në mënyrë të tillë që të lejojnë qarkullimin normal të mjeteve.

6. ***Rikonstruksion teresor dhe ndertimi i palestres se shkolles se bashkuar Orenje***

Objekti ndodhet ne territorin adminitrativ te Bashkise Librazhd. Objekti eshte nje godine 2 kateshe me forme drejtkendeshi. Siperfaqja e gjurmes se tij eshte 548 m2 me nje siperfaqe totale 1096 m2. Aktualisht ne shkolle mesojne 131 nxenes dhe 22 femije parashkollor, me nje staf prej 27 mesues dhe edukatore. Gjendja ekzistuese: dyert dhe dritaret te amortizuara, sistemi i kananlizimeve është problematik. Mungon infrastruktura sportive dhe gjelberimi. Shtresat dysheme jane te amortizuara. Suvatimet jane te demtuara. Rrjeti elektrik nuk perballon ngarkesen. Mungon rrjeti MNZ nuk ka ambiente hidrosanitare dhe nuk ka sistem ngrohje qendrore. Nevojiten ambiente te reja per normalizimin e mesimit. Qellimi kryesor i projektit eshte qe nxenesit te ndihen sa me rehat ne ambjentet e shkollës si brenda por edhe jashte.

7. ***Mbrojtja lumore e zones perendimore te qytetit Faza III***

Ky segment eshte vazhdimi i Lotit II. Projekti konsiston kryesisht ne krijimin e nje hapesire rekreative per banoret e qytetit duke sheërbyer si shetitore pergjate bregut te Lumit Shkumbin,

por njekohesisht edhe si mbrojtje nga permbytjet qe mund te shkaktohen nga lumi here pas here per zonat perreth. Gjatesia totale e projektit eshte 650 ml.

8. ***Rikonstruksioni I Rruges Se Zallit Zdrajsh Verri - Floq, Faza-I***

E gjithe gjatesia e rruges eshte me zhavor dhe material vendi por faktoret atmosferike si reshjet ,gerryerjet e krijuara ne trupin e rruges si pasoje e mos sistemimit te ujrave te shiut kane sjelle deformimin e trupit te rruges. Gropat e shumta te krijuara ne rruge bejne qe levizja me mjet te jete e veshtire sidomos ne kohet me shi. Infrastruktura rrugore ekzistuese në këtë segment është e amortizuar per shkak te viteve qe kane qene projektuar dhe mirembajtja e ulet. Rruga në fjalë propozohet të trajtohet me gjerësi të trupit të rrugës (pjesës kaluese) 3.5 m (shtresë asfaltike), në mënyrë të tillë që të lejojnë qarkullimin normal të mjeteve të emergjencës bankina nga 0.5m në të nje anët e rrugës dhe kunete 0.5 m ne tjetren. Është një rrugë me gjatësi 4 km në fazën e parë.

9. ***Rikonstruksion fasadat e qytetit me çati***

Ky investim synon sistemimin dhe rikonstruksionin e fasadave të objekteve përgjatë akseve kryesore urbane, përmes ndërtimit të çative mbrojtëse, me qëllim përmirësimin e sigurisë, estetikës urbane dhe mbrojtjes së ndërtesave nga faktorët atmosferikë.

**Gjendja aktuale-** Aktualisht, një pjesë e konsiderueshme e ndërtesave në qytet janë pa çati funksionale ose me çati të dëmtuara, kanë fasada të amortizuara dhe të ekspozuara, pësojnë dëmtime të vazhdueshme nga reshjet dhe lagështira dhe paraqesin rrezik për sigurinë e kalimtarëve dhe banorëve. Kjo gjendje ndikon negativisht në imazhin urban dhe mirëmbajtjen e ndërtesave.

10. ***Rikonstruksion i rrugeve Rurale dhe Veprave te Artit te Bashkise Librazhd***

Qellimi i ketij projekti eshte rehabilitimi i segmenteve rrugore te rrezikshme ne fshatrat e bashkise Librazhd nepermjet veprave te artit dhe ndertimit te shtresave rrugore te qendrueshme pasi gjate dimrit kushtet atmosferike çojne ne amortizimin e disa prej segmenteve rrugore.

11. ***Sistemim asfaltim rruga Xhyre Qender- Xhyre Mal***

Xhyra eshte fshat i bashkise Librazhd, i njesise administrative Hotolisht, me nje distance rreth qytetit te Librazhdit afro 10 km. Fshati shtrihet pergjate lumit Shkumbin, ku vijon shtrihet ne majat e shkembijve perreth. Ne te kater stinet e vitit fshati Xhyres ofron bukuri natyrore. Zona e Xhyrës është nga ata zona që nuk është studiuar në thellësi për të njohur historinë që fshihet në këto male, por fakti që në këtë zonë gjenden gjurmë të rrugës së vjetër Egnatia e që Gjorg Golemi luftontë në këto anë në mbështetje të Skënderbeut tregon që kjo zonë ka një histori të vjetër e të pasur. Vendosja në mes të Gegërisë e Toskërisë dhe me një komunitet Gollobordas në veri të saj e bëjnë këtë kulturë të larmishme në dialekte, në veshje të ndryshme popullore e tradita. Banorët vendas si dhe emigrantë të kthyer i kanë dhënë kuptim dhe hijeshi jetës atje. Shtëpitë e rindërtuara dhe kthimi i tyre në bujtina pritëse për turistët, është burimi kryesor i të ardhurave ekonomike. Zona e fshatit te Xhyres njihet per bujqesine dhe blegtorine e zhvilluar. Ne fshat jane hapur bujtina ku ofrojne ushqime tradicionale por jo vetem pasi duke u shtrire pergjate rrjedhes se lumit Shkumbin nuk mungon peshku. Historiku i Fshatit Xhyre identifikohet me "Kalane e Xhyres" dhe segmentin e rruges "Egnatia". Rruga e asfaltuar eshte ne gjatesine 2 km deri ne qender te

fshatit Xhyre. Segmenti I rruges se parikonstruktuar eshte ne gjatesine 3 km.Kjo rruge i sherben ne menyre direkte banoreve te ketij fshati, jane rruge dytesore dhe segmente qe aktualisht ne terren jane ne kushte fizike jo te mira. Sherbejne si rruge kalimi per automjetet. Veshtiresi paraqitet ne keto segmente kryesisht gjate muajve te dimrit ku keto akse jane kthesa te forta dhe pa bazament te qendueshem.

**12. *Rikonstruksion i Muzeut Etnografik***

Muzeu etnografik i qytetit te Librazhdit shenjon gjurme te histories dhe trashegimise se qytetit te Librazhdit dhe krahinave perreth. Qe nga ndertimi ne kete objekt kane munguar investimet. Godinat e muzeve, të cilat shpalosin trashëgiminë tonë historike e kulturore janë ndërtesa me karakter përfaqësues dhe shumë të veçantë. Ato ekspozojnë dhe njëkohësisht shërbejnë si një mbështjellje mbrojtëse ndaj kushteve të jashtme klimatike të objekteve të rëndësishme dhe në disa raste unike të trashëgimisë tone.Nisur nga rendesia qe ka per qytetin e Librazhdit, mbetet nder investimet prioritare rikonstruksioni i tij. Muzeu Librazhd eshte nje objekt 2 kate mbi toke, ne forme te rregullt gjeometrike ne plan dhe lartesi. Amortizimi nder vite dhe mos nderhyrjet ne mirembajtjen e objektit kane bere qe gjemdja fizike te paraqet ne nivel te larte demtimesh.

**13. *Rehabilitimi urban blloku banimit nr.3 (Lagje Stacioni i Trenit) Bashkia Librazhd***

Ky investim prioritar ka te beje me sistemimin e rrugeve te pashtruara, fasadat e pallateve rehabilitimin e shesheve te pushimit si dhe sistemimi i ujerave te bardha (KUB) si dhe sistemimi i ujerave te ndotura (KUZ).

*Konceptoi:A.Haskurti*

P/V Nº 7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA LIBRAZHD**
**DREJTORIAE TË ARDHURAVE VENDORE**

**PROJEKT - V E N D I M**

Nr ____Datë _____/_____2026

**"PËR CAKTIM AGJENTI TATIMOR PËR VITIN 2026"**

Në mbështetje te Ligjit 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore",Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar me Ligjin nr.106/2017, datë 30.11.2017, VKM Nr. 132 , date 07.03.2018" Për Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme te Pasurisë se Paluajtshme "Ndërtesa " e bazës së taksës për kategori specifike",VKB Nr.106, date 23.12.2025 " Për Miratimin e taksave dhe tarifave Vendore për vitin 2026" me propozim të Kryetarit të Bashkisë ,Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë ___/___/2026.

**V E N D O S I:**

1- Të miratojë Agjent Tatimor Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Elbasan, për vjeljen e Taksave dhe të Tarifave Vendore ( tarifës së pastrimit, taksës së ndërtesës, tarifës së gjelbërimit, tarifës së ndricimit, tarifa te tjera ) të abonentëve familjare për vitin 2026 e në vazhdim.
2- Masa e shpërblimit të agjentit tatimor do të jetë 2 % e vlerës së arkëtuar.
3- Vjelja e detyrimit të pasqyrohet në faturën tatimore, detyrimi për çdo familje do të përpjestohet në muaj sipas marreveshjes që do të lidhet me Shoqërinë Rajonale te Ujësjellës Kanalizime .
4- Ndjek zbatimin e këtij vendimi , Sektori Juridik , Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e të Ardhurave Vendore ,Bashkia Librazhd .
5- Ky urdhër hyn në fuqi mbas 10 ditësh nga dalja e Vendimit të Këshillit Bashkiak.

Konceptoi : L. Shuli

**KRYETARI I BASHKISË**
**Mariglen Disha**

Adresa : Sheshi "Gjorg Golemi"Librazhd, www.bashkialibrazhd.gov.al info@bashkialibrazhd.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISË
**BASHKIA LIBRAZHD**
**DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE**

***Librazhd më, 18.03.2026***

# ***R E L A C I O N***

## " PËR
## CAKTIMIN E AGJENTIT TATIMOR PËR TAKSA E TARIFA VENDORE PËR VITIN 2026"

**Të nderuar Këshilltarë :**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139 /2015, datë 17.02.2015 " Për Vetë qeverisjen Vendore " i ndyshuar si dhe Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, " Për Sistemin e Taksave Vendore",i ndryshuar, ,Ligjit Nr.9920 , datë 19.05.2008 " Për Procedurat Tatimore në Republiken e Shqiperisë", Ligjit Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" ,si dhe në zbatim të VKB Nr .106, datë 23.12.2025 " Paketa Fiskale 2026 " kërkojmë që të miratohet Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Elbasan si Agjent Tatimor për vjeljen e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2026 e në vazhdim , si një mundësi shumë e mirë për vjelen e detyrimeve familjare.

Vjelja e taksave dhe tarifave do të shtrihet në disa muaj sipas marrëveshjes që do të lidhet midis Bashkisë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Elbasan.

Masa e shpërblimit si agjent tatimor do të jetë 2 % e vleres së arkëtuar .

Sa më lart kërkojmë që të miratohet projekt- vendimi për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore të familjarëve për vitin 2026.

Ju faleminderit !

**DREJTORE E TË ARDHURAVE VENDORE**
**Lindita Shuli**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LIBRAZHD**
**DREJTORIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME**

P/U
Nº 8

**PROJEKT VENDIM**

**Nr _____datë____/____/2026**

**"PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" (pas vdekjes)**

**PËR Z. ARIANIT ALLIU**

Në mbështetje të: Nenit 9, pika 1, dhe nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Kompetencave të Këshillit Bashkiak i cili parashikon dhënien e titujve të nderit dhe mirënjohjes si dhe në vlerësim të kontributit të shquar në jetën kulturore dhe artistike të qytetit; Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, i propozojmë Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij të datës ___/___/ 2026 të:

**TË VENDOSI :**

1. Dhënien e Titullit "Qytetar Nderi"(pas vdekjes) z.Arianit Alliu, me motivacionin "*Për nivelin e lartë artistik dhe kontributin e spikatur në zhvillimin e jetës kulturore të qytetit, si dhe për promovimin me dinjitet të vlerave folklorike të Librazhdit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.*"

2. Ngarkohet për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi, Drejtoria e Funksioneve të Patransferueshme, dhe Drejtoria e Turizmit, Kulturës dhe Rinisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë, pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË**
**Mariglen Disha**

# ***RELACION***

## Per Keshillin Bashkiak

Në lidhje me Projekt- Vendimin:

**"PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" (pas vdekjes) PËR z. ARIANIT ALLIU"**

I ndjeri Arianit Alliu, i lindur më 01.05.1974 në Librazhd dhe ndarë nga jeta në vitin 2020, mbetet një figurë e njohur dhe shumë e respektuar në fushën e artit dhe kulturës. Ai përfundoi studimet e larta në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, në degën Sociologji-Filozofi, duke ndërtuar një profil të qëndrueshëm intelektual dhe artistik.

Angazhimi i tij në art nisi që në moshë të hershme, fillimisht si baterist dhe më pas si valltar në Pallatin e Kulturës "Sadi Halili", ku u bë pjesë e shumë aktiviteteve dhe shfaqjeve artistike. Më tej, ai kontribuoi si koreograf i jashtëm pranë Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke krijuar dhe formuar grupe valltarësh dhe duke ndikuar ndjeshëm në edukimin artistik të brezave të rinj.

Gjithashtu, për një periudhë 5-vjeçare ai ushtroi detyrën e përgjegjësit të Pallatit të Kulturës "Sadi Halili", duke dhënë një kontribut të vyer në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike në qytetin e Librazhdit.

Gjatë gjithë veprimtarisë së tij, i ndjeri Arianit Alliu u dallua për angazhimin e tij si valltar dhe këngëtar në promovimin e traditave dhe folklorit të zones, kontributin në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike, drejtimin dhe mbështetjen e talenteve të reja artistike, përfaqësimin dinjitoz të kulturës lokale në aktivitete dhe festivale të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, arritjet dhe sukseset në aktivitete ndërkombëtare, duke rritur vlerësimin për kulturën dhe traditat tona, përkushtimin dhe pasionin për artin, duke mbetur një shembull frymëzues për komunitetin.

Puna dhe kontributi i tij kanë ndikuar ndjeshëm në pasurimin e jetës kulturore të komunitetit dhe në ruajtjen e identitetit artistik dhe folklorik të zonës. Edhe pse është ndarë nga jeta në vitin 2020, vepra dhe ndikimi i tij vijojnë të mbeten të gjalla në kujtesën dhe jetën kulturore të qytetit.

Për sa më sipër, vlerësojmë se dhënia e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) për të ndjerin Arianit Alliu përbën një vlerësim të merituar institucional dhe një akt mirënjohjeje për kontributin e tij të çmuar në shërbim të komunitetit.

**Konceptoi: Elona Koçi**

Kabineti 18.03.2026

1614
Dt 18.03.2026

# ANSAMBLI I VALLËS SË PALLATIT TË KULTURËS

**PROPOZIM ZYRTAR**

Librazhd, më 12..03.2026

Drejtuar:

Këshillit Bashkiak të Bashkisë Librazhd

Kryetarit të Bashkisë, z. Mariglen Disha

Të nderuar Këshilltarë

**Lënda:** Propozim për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" pas vdekjes të Bashkisë Librazhd

I nderuar Kryetar i Bashkisë,

Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në mbështetje të kompetencave që i njeh ligji Këshillit Bashkiak për dhënien e titujve të nderit dhe duke vlerësuar kontributin e spikatur në jetën kulturore dhe artistike të komunitetit, paraqesim këtë propozim për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" pas vdekjes për z. Arianit Alliu.

Z. Arianit Alliu është një figurë e njohur dhe e respektuar në jetën kulturore të qytetit. Gjatë veprimtarisë së tij shumëvjeçare ai ka dhënë një kontribut të çmuar si valltar, këngëtar dhe drejtues i Pallatit të Kulturës, duke promovuar vlerat artistike dhe folklorike të zonës dhe duke kontribuar në zhvillimin e aktiviteteve kulturore në komunitet.

Gjatë veprimtarisë së tij artistike dhe kulturore, ai është dalluar për:

- angazhimin si valltar dhe këngëtar në promovimin e traditave dhe folklorit të zonës;
- kontributin në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike;
- drejtimin e Pallatit të Kulturës dhe mbështetjen e talenteve të reja artistike;
- përfaqësimin dinjitoz të kulturës lokale në aktivitete dhe festivale të ndryshme;

- përkushtimin dhe pasionin për artin, duke shërbyer si shembull frymëzues për brezat e rinj.

Puna dhe kontributi i tij kanë ndikuar ndjeshëm në pasurimin e jetës kulturore të komunitetit dhe në ruajtjen e identitetit artistik dhe folklorik të zonës sonë.

Në këtë kuadër, vlerësojmë se dhënia e titullit "Qytetar Nderi" për z. Arianit Alliu do të përbënte një akt të merituar mirënjohjeje institucionale dhe një shembull frymëzues për komunitetin dhe brezat që vijnë.

Duke ju falënderuar për vëmendjen dhe shqyrtimin e këtij propozimi, mbetemi në pritje të vendimmarrjes suaj.

Me respekt,

Ansambli i Valles së Pallatit të Kulturës

Azra Kaso

Uendi Alla

Lusinda Hoxha

Frenci Pitris

Kejsi Pitris

Elio Alliu

Frensi Dobra

Mariana Xhaka

Alteo Hala

SHTOJCË

Biografi e shkurtër

Arianit Alliu

Arianit Rustem Alliu ka lindur më 01.05.1974 në Librazhd. Arsimin 8-vjeçar e ka kryer në shkollën "Genc Leka", ndërsa arsimin e mesëm në gjimnazin "Ibrahim Muça" në Librazhd.

Studimet e larta i ka përfunduar në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, në degën Sociologji – Filozofi.

Që në moshën 14-vjeçare është angazhuar në aktivitetet artistike si baterist. Në moshën 22-vjeçare u angazhua si valltar në Shtëpinë e Kulturës, duke marrë pjesë në aktivitete dhe shfaqje të ndryshme artistike.

Rreth vitit 2010 ai punoi si koreograf i jashtëm pranë Qendrës Kulturore të Fëmijëve, ku krijoi dhe formoi grupin e tij të valltarëve.

Gjithashtu ka punuar për 5 vite si përgjegjës i Shtëpisë së Kulturës, duke dhënë kontribut në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve artistike dhe kulturore në qytetin e Librazhdit.

Jeta familjare

Arianit Alliu është fëmija i fundit i Rustemit dhe Sofisë dhe ka 3 motra dhe 2 vëllezër.

Në vitin 2002 u martua me bashkëshorten Majlinda dhe së bashku kanë 3 djem: Arlind, Elion dhe Marlin.

Në vitin 2020 u nda nga jeta .

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME

P|U
ST=P

**PROJEKT VENDIM**

**Nr _____datë____/____/2026**

**PËR EMËRTIMIN E NJË SEGMENTI RRUGOR NË FSHATIN FUNARËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE ORENJË, ME EMRIN "XHEVAHIR BALLIU"**

Në mbështetje të: Nenit 9, pika 1, dhe nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Kompetencave të Këshillit Bashkiak për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe objekteve publike në territorin e bashkisë; Kërkesës së paraqitur nga familjarët/banorët e fshatit Funarës për emërtimin e një rruge; Vlerësimit të kontributit shoqëror dhe komunitar të të ndjerit Xhevahir Balliu (1945–1976); Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, i propozojmë Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij të datës ___/___/ 2026 të:

**TË VENDOSI :**

1. Të emërtohet një rrugë në fshatin Funarës, Njësia Administrative Orenjë, Bashkia Librazhd, me emrin: Rruga "Xhevahir Balliu".

3. Ngarkohet për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi, Drejtoria e Funksioneve të Patransferueshme, Drejtoria e Punëve Publike pranë Bashkisë Librazhd dhe Njësia Administrative Orenjë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë, pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË**
**Mariglen Disha**

198

Dt 13.01.2026

# Kerkese

Drejtuar: Bashkisë Librazhd

Kryetarit të Bashkisë

Këshillit Bashkiak

I nderuar z. Kryetar

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Nëpërmjet kësaj kërkese, ne familjarët e te ndjerit Xhevahir Arif Balliu banues te fshatit Funarës, Njësia Administrative Orenjë, drejtohemi pranë Bashkisë Librazhd me kërkesën për emërtimin e një rruge në këtë fshat me emrin e të ndjerit Xhevahir Balliu (1945–1976).

I ndjeri Xhevahir Balliu ka qenë një figurë e respektuar në komunitetin tonë, i njohur për kontributin e tij në punë dhe në shërbim të shoqërisë, si dhe për vlerat njerëzore që ka përfaqësuar. Ai ra ne krye te detyres gjate punimeve per hapjen e tunelit ne Qafe Thane. I ndjeri ka marre titullin e Urdhrit te Punes nga Presidiumi i Kuvendit Popullor te Republikes Popullore Socialiste Te Shqipersie ne vitin 1979. Emërtimi i një rruge me emrin e tij do të ishte një akt nderimi dhe mirënjohjeje, jo vetëm për familjen, por edhe për gjithë komunitetin e Funarësit, duke ruajtur gjallë kujtesën dhe vlerat që ai ka përfaqësuar.

Ju lutemi të shqyrtoni këtë kërkesë dhe, nëse është e mundur, ta përfshini në procedurat ligjore dhe administrative përkatëse për miratim nga organet kompetente të Bashkisë Librazhd.

Duke ju falenderuar për vëmendjen dhe mirëkuptimin, mbetemi në pritje të një përgjigjeje pozitive.

Me respekt,

Rrahman Kodra

KERKESE

Ishte data 9 nentor 1976 familja jone perjetoi me ngjarjen tragjike ku vellai im ra ne krye te detyres Xhevahir Arif Balliu ne tunelin e qafe thanes.

Po ne ate kohe I ndjeri vellai im dekorohet nga kuvendi popullor me titullin "Naim Frasheri" heroi i punes.

Kerkojme nga keshilli I Bashkise i rethit Librazhd.

Qe te emertohet ne fshatin Funares sheshi me emin e vellait.

1- Qendra e autobuzave ne funares ge lidh rrugen e fshatrave Zdranjsh- Neshte.

Mbetemi me sprese ge kerkesa jone do meret ne konsiderate.

Me respekte nga vellai i te ndjerit Rahm Arif Kodra

Naim Balliu
Ali Hirda
Riza Sota
Hyqmet Balliu
Sheqet Luka
Jorma Kodra
Hamit Goma

BASTRI LUKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - NJËSIA ADMINISTRATIVE ORENJË - BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI I FSHATIT FUNARËS

# <u>*R E L A C I O N*</u>

## Per Keshillin Bashkiak

Në lidhje me Projekt- Vendimin:

**"PËR EMËRTIMIN E NJË SEGMENTI RRUGOR NË FSHATIN FUNARËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE ORENJË, ME EMRIN "XHEVAHIR BALLIU"**

Xhevahir Arif Balliu ka lindur në fshatin Funarës, të rrethit Librazhd, më 15 janar 1945. Ai ishte banor autokton i zonës dhe i lidhur ngushtë me komunitetin ku u rrit dhe u formua. Që në moshë të re, Xhevahir Balliu u angazhua në punë dhe shërbim shoqëror. Në moshën 17-vjeçare, më 9 tetor 1962, ka nisur punë në Ndërmarrjen e Hekurudhës, duke u bërë pjesë e kolektivit të punëtorëve të ndërtimit të veprave hekurudhore.

Nga viti 1969, Xhevahir Balliu ka qenë pjesë e punimeve për hapjen e tuneleve hekurudhore, përfshirë tunele të vështira si ato të Murashit dhe Tunelit të Qafë Thanës, ku puna kryhej në kushte të rënda fizike dhe teknike. Në komunitet dhe në kolektivin e punës njihej si njeri i ndershëm, i respektuar dhe bashkëpunues, duke gëzuar respektin e shokëve të punës dhe drejtuesve.

Xhevahir Balliu ndërroi jetë në vendin e punes ne vitin 1976, në moshë të re, duke lënë pas një humbje të ndjeshme për familjen, kolektivin e punës dhe komunitetin e fshatit Funarës. Vdekja e tij e parakohshme u konsiderua një humbje e madhe për kolektivin ku ai shërbeu dhe për njerëzit që e njohën. I ndjeri ka marre titullin e Urdhrit te Punes nga Presidiumi i Kuvendit Popullor te Republikes Popullore Socialiste Te Shqipersie ne vitin 1979.

Figura e tij është përkujtuar ndër vite si shembull i përkushtimit në punë dhe i vlerave njerëzore, ndërsa emri i tij vazhdon të ruhet me respekt në kujtesën e komunitetit lokal.

Duke u mbështetur në jetën, origjinën dhe kontributin shoqëror të të ndjerit Xhevahir Balliu, si dhe në kërkesën e familjarëve dhe komunitetit të fshatit Funarës, propozohet miratimi i projekt-vendimit për emërtimin e një rruge lagjeje me emrin e tij.

Bashkëngjitur gjendet:

1. Kërkesën nga familjarët
2. Firma nga anëtarët e lagjes
3. Hartën e vijëzuar ku propozohet emërtimi rrugës
4. Vendimi nga Autoriteti per Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit te Shtetit

**Konceptoi: Elona Koçi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Nr. 499/27 Prot. Tiranë, më 09.03.2026

## VENDIM

**Nr. 125 Datë 03.03.2026**

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 03.03.2026, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Z. Albert Nikolla Anëtar
Z. Altin Hoxha Anëtar
Z. Gjergj Marku Anëtar
Z. Skënder Vrioni Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Kërkesa e paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Librazhd, me shkresën nr. 670 prot., datë 03.02.2026, "Kërkesë për informacion", për verifikimin e figurës së z. Xhevahir Balliu, kandidat i propozuar për emërtimin e një rruge në fshatin Funarës.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 45/2015 *"Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*.

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi kërkesën për informacion të paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Librazhd, me shkresën nr. 670 prot., datë 03.02.2026, sipas objektit të saj,

## VËREN:

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

Në nenin 10, pika "dh" të Ligjit nr. 45/2015, një nga detyrat e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është edhe informimi i individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.

Nga përmbajtja e shkresës nr. 670 prot., datë 03.02.2026, "Kërkesë për informacion", Institucioni i Bashkisë Librazhd, në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 45/2015 *"Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*, i ka kërkuar Autoritetit nëse disponon informacion, lidhur me z. Xhevahir Balliu, kandidat i propozuar për emërtimin e një rruge në fshatin Funarës, me përmbajtje sipas shkresës së dërguar nga Bashkia Librazhd.

Mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera deri tani referuar të dhënave të paraqitura nga institucioni kërkues, për z. Xhevahir Balliu, nuk figuron të ketë materiale në emër të tij, sipas Nenit 30, të Ligjit Nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar.

**PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 *"Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 *"Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike"*, Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

**V E N D O S I**

1.Të informojë Institucionin e Bashkisë Librazhd, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 670 prot., datë 03.02.2026, "Kërkesë për informacion", në kuadër të propozimit për emërtimin e një rruge në fshatin Funarës, se nga verifikimet e kryera deri tani, sipas përcaktimeve të nenit 30 të Ligjit nr. 45/2015 *"Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë",* i ndryshuar rezulton se z. Xhevahir Balliu:

a) Nuk ka qenë anëtar ose kandidat të Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese posaçme politike, apo punonjës i nivelit të lartë i ish-Sigurimit të Shtetit;
b) Nuk ka qenë bashkëpunëtor të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, denoncues në proceset politike ose dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme, pas mbushjes së moshës 18 vjeç;
c) Nuk ka qenë person me të dhëna nga ish-Sigurimi i Shtetit për spiunazh dhe terrorizëm.

2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet institucionit të Bashkisë Librazhd.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

**KRYETARJA**
**Dr. Gentiana Sula**

**Në mungesë dhe me Urdhër**

**ANËTAR**

**Altin Hoxha**

| **ANËTAR** | **ANËTAR** | **ANËTAR** |
|---|---|---|
| **Dr. Albert Nikolla** | **Gjergj Marku** | **Skënder Vrioni** |

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga Kongresi i Manastirit, Garnizoni "Skënderbej", Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al
email:info@autoritetidosjeve.gov.al

# *RELACION*

## Per Keshillin Bashkiak

Në lidhje me Projekt- Vendimin:

**PËR EMËRTIMIN E NJË SEGMENTI RRUGOR NË FSHATIN FUNARËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE ORENJË, ME EMRIN "XHEVAHIR BALLIU"**

Xhevahir Arif Balliu ka lindur në fshatin Funarës, të rrethit Librazhd, më 15 janar 1945. Ai ishte banor autokton i zonës dhe i lidhur ngushtë me komunitetin ku u rrit dhe u formua. Që në moshë të re, Xhevahir Balliu u angazhua në punë dhe shërbim shoqëror. Në moshën 17-vjeçare, më 9 tetor 1962, ka nisur punë në Ndërmarrjen e Hekurudhës, duke u bërë pjesë e kolektivit të punëtorëve të ndërtimit të veprave hekurudhore.

Nga viti 1969, Xhevahir Balliu ka qenë pjesë e punimeve për hapjen e tuneleve hekurudhore, përfshirë tunele të vështira si ato të Murashit dhe Tunelit të Qafë Thanës, ku puna kryhej në kushte të rënda fizike dhe teknike. Në komunitet dhe në kolektivin e punës njihej si njeri i ndershëm, i respektuar dhe bashkëpunues, duke gëzuar respektin e shokëve të punës dhe drejtuesve.

Xhevahir Balliu ndërroi jetë në vendin e punes ne vitin 1976, në moshë të re, duke lënë pas një humbje të ndjeshme për familjen, kolektivin e punës dhe komunitetin e fshatit Funarës. Vdekja e tij e parakohshme u konsiderua një humbje e madhe për kolektivin ku ai shërbeu dhe për njerëzit që e njohën. I ndjeri ka marre titullin e Urdhrit te Punes nga Presidiumi i Kuvendit Popullor te Republikes Popullore Socialiste Te Shqipersie ne vitin 1979.

Figura e tij është përkujtuar ndër vite si shembull i përkushtimit në punë dhe i vlerave njerëzore, ndërsa emri i tij vazhdon të ruhet me respekt në kujtesën e komunitetit lokal.

Duke u mbështetur në jetën, origjinën dhe kontributin shoqëror të të ndjerit Xhevahir Balliu, si dhe në kërkesën e familjarëve dhe komunitetit të fshatit Funarës, propozohet miratimi i projekt-vendimit për emërtimin e një rruge lagjeje me emrin e tij.

Bashkëngjitur gjendet:

1. Kërkesën nga familjarët
2. Firma nga anëtarët e lagjes
3. Hartën e vijëzuar ku propozohet emërtimi rrugës
4. Vendimi nga Autoriteti per Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit te Shtetit

**Konceptoi: Elona Koçi**

P/V
Nº 10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME

**PROJEKT VENDIM**

**Nr _____datë____/____/2026**

**PËR EMËRTIMIN E NJË SEGMENTI RRUGOR NË FSHATIN STEBLEVË, NJËSIA ADMINISTRATIVE STEBLEVË , ME EMRIN "AJDIN MUSTAFA BAUSHI"**

Në mbështetje të: Nenit 9, pika 1, dhe nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Kompetencave të Këshillit Bashkiak për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe objekteve publike në territorin e bashkisë; Kërkesës së paraqitur nga familjarët, për emërtimin e një rruge; Vlerësimit të kontributit shoqëror dhe komunitar të të ndjerit Ajdin Mustafa Baushi; Me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, i propozojmë Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij të datës ___/___/ 2026 të:

**TË VENDOSI :**

1. Të emërtohet një rrugë në fshatin Steblevë, Njësia Administrative Steblevë, Bashkia Librazhd, me emrin: Rruga "Ajdin Mustafa Baushi".

3. Ngarkohet për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi, Drejtoria e Funksioneve të Patransferueshme, Drejtoria e Punëve Publike pranë Bashkisë Librazhd dhe Njësia Administrative Steblevë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë, pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË**
**Mariglen Disha**

# RELACION

## Per Keshillin Bashkiak

Në lidhje me Projekt- Vendimin:
**PËR EMËRTIMIN E NJË SEGMENTI RRUGOR NË FSHATIN STEBLEVË, NJËSIA ADMINISTRATIVE STEBLEVË, ME EMRIN "AJDIN MUSTAFA BAUSHI"**

Ajdin Mustafa Baushi ka lindur më 1 tetor 1907 në fshatin Steblevë, nga prindërit Demka Terziu Baushi dhe Mustafa Baushi. I ati, Mustafa Baushi, kishte përfunduar studimet në Medresenë e Stambollit, ku kishte marrë titullin Imam. Femijerine deri në moshën trevjeçare Ajdini e kaloi në Steblevë pranë nënës së tij, ndërsa i ati dhe dy djemtë e tjerë të familjes kishin emigruar në Selanik për punë dhe studime. Në pranverën e vitit 1910, familja u ribashkua në Steblevë, por po atë vit fshati u përfshi nga epidemia vdekjeprurëse e kolerës. Si pasojë, dy vëllezërit e Ajdinit, Abdurrahmani dhe Midili, përkatësisht 18 dhe 20 vjeç, ndërruan jetë tragjikisht në të njëjtën ditë dhe u varrosën në Steblevë. Pas kësaj fatkeqësie, Mustafa Baushi, së bashku me bashkëshorten dhe Ajdinin trevjeçar, u detyrua të emigronte sërish në Selanik. Aty Ajdini mori mësimet e para në shkollën turke të qytetit, ku përvetësoi gjuhën turke dhe greke.

Në vitin 1916, në moshën vetëm 9-vjeçare, Ajdini humbi edhe nënën e tij, Demkën, duke mbetur jetim. Rritja, edukimi dhe shkollimi i tij u morën përsipër nga i ati, i cili e arsimoi fillimisht në ciklin e ulët dhe më pas në shkollën e kuzhinës, duke e bërë një kuzhinier profesionist.

Në vitin 1924, si pasojë e represionit grek ndaj shqiptarëve dhe myslimanëve, Mustafa Baushi dhe i biri Ajdin u detyruan të largoheshin nga Selaniku dhe u vendosën në Shkup. Aty Ajdini u martua me Aishe Lama, bijë e një familjeje me tradita të spikatura patriotike. Në Shkup, Ajdini punoi si kuzhinier së bashku me kunatin e tij, të njohur si "Usta Murati", figurë që përmendet edhe sot në këngët popullore të dasmave. Gjatë kësaj periudhe ai përvetësoi edhe gjuhën maqedonase.

Në vitin 1930, Ajdin Baushi u kthye përfundimisht në atdhe së bashku me familjen, babain Mustafa, bashkëshorten dhe dy vajzat e vogla. Familja u vendos në fshat, ndërsa Ajdini, si kuzhinier profesionist, filloi punë në Tiranë, ku hapi dyqanin e tij në Pazarin e Vjetër.

Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, dyqani i tij u shndërrua në një bazë të rëndësishme të lëvizjes antifashiste. Ajdini shërbeu si ndërlidhës i rezistencës, duke shpërndarë letra dhe trakte të ndryshme. Për këtë qëllim, krahas punës si kuzhinier, ai ushtronte edhe aktivitetin e tregtarit ambulant, gjë që i lehtësonte lëvizjen dhe veprimtarinë. Njohja e gjuhës italiane e ndihmoi që të mos binte në dyshimet e pushtuesve.

Ngjarja e 4 shkurtit 1944, e njohur si "Nata e Shën Bartolomeut", mbetet një nga momentet më tragjike të historisë së Tiranës. Gjatë kësaj nate, Ajdin Baushi i shpëtoi ekzekutimit vetëm falë faktit se njihej si tregtar ambulant dhe për njohjen e gjuhës italiane. Përveç angazhimit në qytet,

Ajdini ishte i lidhur fort me Steblevën. Çdo verë ai kthehej në fshat për të ndihmuar familjen dhe komunitetin, duke marrë pjesë aktive në punët e përbashkëta dhe jetën shoqërore. Ajdin Mustafa Baushi ndërroi jetë më 17 dhjetor 1968, në moshën 61-vjeçare, pas një sëmundjeje të rëndë, në praninë e bashkëshortes dhe nëntë vajzave të tij. Ai la pas nëntë vajza, të cilat u edukuan me vlera të larta morale dhe arsimore. Katër prej tyre u shkolluan në Universitetin e Tiranës dhe u bënë kuadro të përkushtuara në shërbim të vendit, ndërsa të tjerat përfunduan studimet e larta dhe kontribuuan me ndershmëri në fusha të ndryshme. Sot familja Baushi numëron rreth 100 anëtarë, me një nivel të lartë arsimimi dhe kontributesh në ekonomi, arsim, shëndetësi, art dhe shërbim publik.

Familja e Ajdin Mustafa Baushit ka qenë dhe mbetet një nga familjet më të respektuara të fshatit Steblevë. Vetë Ajdini gëzoi respekt të veçantë si në vendlindje ashtu edhe në Tiranë, ku punoi dhe jetoi, duke lënë gjurmë si qytetar i ndershëm, punëtor dhe atdhetar.

Në respekt dhe mirënjohje për jetën, veprën dhe kontributin e tij, si bir i Steblevës, si familjar shembullor dhe si kontribuues i çmuar i komunitetit dhe i atdheut, familjarët propozojnë që rruga që të çon drejt truallit të shtëpisë së tij të emërtohet;Rruga "Ajdin Mustafa Baushi".

Bashkëngjitur gjendet:

1. Kërkesën nga familjarët
2. Miratimi nga Njesia Administrative Stebleve
3. Hartën e vijëzuar ku propozohet emërtimi rrugës
4. Vendimi nga Autoriteti per Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit te Shtetit

**Konceptoi: Elona Koci**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 499/26 Prot. Tiranë, më 09.03.2026

**VENDIM**

**Nr. 124 Datë 03.03.2026**

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 03.03.2026, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

| | |
|---|---|
| Z. Albert Nikolla | Anëtar |
| Z. Altin Hoxha | Anëtar |
| Z. Gjergj Marku | Anëtar |
| Z. Skënder Vrioni | Anëtar |

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Kërkesa e paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Librazhd, me shkresën nr. 664 prot., datë 03.02.2026, "Kërkesë për informacion", për verifikimin e figurës së z. Ajdin Baushi, kandidat i propozuar për emërtimin e një rruge në fshatin Steblevë.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 45/2015 *"Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*.

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi kërkesën për informacion të paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Librazhd, me shkresën nr. 664 prot., datë 03.02.2026, sipas objektit të saj,

**VËREN:**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

Në nenin 10, pika "dh" të Ligjit nr. 45/2015, një nga detyrat e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është edhe informimi i individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.

Nga përmbajtja e shkresës nr. 664 prot., datë 03.02.2026, "Kërkesë për informacion", Institucioni i Bashkisë Librazhd, në zbatim të detyrimeve ligjore që rjedhin nga Ligji nr. 45/2015 *"Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë"*, i ka kërkuar Autoritetit nëse disponon informacion, lidhur me z. Ajdin Baushi, kandidat i propozuar për emërtimin e një rruge në fshatin Steblevë, me përmbajtje sipas shkresës së dërguar nga Bashkia Librazhd.

Mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera deri tani referuar të dhënave të paraqitura nga institucioni kërkues, për z. Ajdin Baushi, nuk figuron të ketë materiale në emër të tij, sipas Nenit 30, të Ligjit Nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar.

**PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*", ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "*Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*", Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

**V E N D O S I**

1.Të informojë Institucionin e Bashkisë Librazhd, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 664 prot., datë 03.02.2026, "Kërkesë për informacion", në kuadër të propozimit për emërtimin e një rruge në fshatin Steblevë, se nga verifikimet e kryera deri tani, sipas përcaktimeve të nenit 30 të Ligjit nr. 45/2015 "*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*", i ndryshuar rezulton se z. Ajdin Baushi:

a) Nuk ka qenë anëtar ose kandidat të Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese posaçme politike, apo punonjës i nivelit të lartë i ish-Sigurimit të Shtetit;

b) Nuk ka qenë bashkëpunëtor të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, denoncues në proceset politike ose dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme, pas mbushjes së moshës 18 vjeç;

c) Nuk ka qenë person me të dhëna nga ish-Sigurimi i Shtetit për spiunazh dhe terrorizëm.

2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet institucionit të Bashkisë Librazhd.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

**KRYETARJA**
**Dr. Gentiana Sula**
**Në mungesë dhe me Urdhër**

**ANËTAR**
**Altin Hoxha**

**ANËTAR**
**Dr. Albert Nikolla**

**ANËTAR**
**Gjergj Marku**

**ANËTAR**
**Skënder Vrioni**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBRAZHD**
**NJËSIA ADMINISTRATIVE STEBLEVË**

Nr. 22/1 prot. Steblevë, më 22.01.2026

Lënda:Dakordësi për emërtimin e rrugës "Rruga Ajdin Mustafa BAUSHI" në fshatin Steblevë.

Drejtura: Bashkisë Librazhd.

Në përgjigje të kërkesës së paraqitur nga familjarët e të ndjerit Ajdin Mustafa BAUSHI, si dhe bazuar në dokumentacionin përkatës dhe vendimet gjyqësore në fuqi, Njësia Administrative Steblevë, në bashkëpunim me Kryesinë e Fshatit Steblevë, shprehin zyrtarisht dakordësinë e plotë për emërtimin e rrugës ku ka lindur dhe ka pasur banesën i ndjeri Ajdin Mustafa BAUSHI, në fshatin Steblevë, Lagjia "e Lajthive", me emërtimin:

**"Rruga Ajdin Mustafa BAUSHI"**

Ky emërtim konsiderohet i drejtë, i arsyeshëm dhe në përputhje me traditën, historinë dhe kontributin e familjes BAUSHI në komunitetin e fshatit Steblevë.

Shkresa lëshohet për t'u përdorur pranë Bashkisë Librazhd dhe Këshillit Bashkiak Librazhd, për vijimin e procedurave përkatëse ligjore.

PËR KRYESINË E FSHATIT STEBLEVË

Kryetari i Fshatit Steblevë

Cvetan DRAPA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NJËSIA ADMINISTRATIVE KRYETARI I FSHATIT STEBLEVË STEBLEVË BASHKIA LIBRAZHD

PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE STEBLEVË

Administratori

Albert KALECI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - NJËSIA ADMINISTRATIVE STEBLEVË - BASHKIA LIBRAZHD

02.02.2026
634

# KËRKESË
# BASHKISË LIBRAZHD
# KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD.

Unë e quajtura Xheni Ajdin Baushi banuese në Tiranë, në Rrugën "Ymer Kurti", Ndërtesa.8, H.3, Ap.24, Parashtroi kërkesën time sa vijon:

Me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nr. 1477 (13-2016-5889) dt. 30. 11. 2016 dhe të Gjykates Apelit Durrës nr. 1020 dt. 17.05. 2018, që ka marrë formën e prerë është vendosur kthimi i pronave të të ndjerit Ajdin Mustafa Baushit, trashëgimtareve në fshatin Steblevë, që është nën administrimin e Bashkisë Librazhd.

Në kushtet e reja të krijuara, ne trashëgimtarët e të ndjerit babait tonë, Ajdin Mustafa BAUSHI në homazh për të kujtuar e lartësuar figurën shumë të çmuar të tij, i lutemi asaj Bashkie dhe Këshillit Bashkiak Librazhd, që të marrë në konsideratë dhe të shqyrtoi në mbledhjen e saj më të afërt kërkesën tonë, që të emërtoi rrugën ku ka lindur dhe ka patur shtëpinë i ndjeri babai ynë Ajdin Mustafa BAUSHI, dhe familja e tij prej nëntë vajzave, njëzetegjashtë nipave, tridhjetenjë stërnipave, dhe dhjetë stërstër nipave, në fshatin Steblevë, "Lagjia e Lajthive":

**Rruga Ajdin Mustafa BAUSHI .**

Bashkangjitur, po iu paraqesim të gjithë dokumentacionin e nevojshëm së bashku me hartën e lagjes dhe të rrugës së fshatit Steblevë si dhe pëlqimin e Zyrës Administrative të fshatit Steblevë të drejtuar nga z. Albert Koleci dhe të Shoqatës "Stebleva" të drejtuar nga z. Mersin Hoxha.

Mbetemi me shpresë se kërkesa jonë do të merret në konsideratë.

KËRKUESIA
Xheni Ajdin BAUSHI

PËR Z/ ADMINISTRATIVE STEBLEVË
Z. Albert KOLECI

PËR SHOQATËN "STEBLEVA"
Z. Mersin HOXHA

P/ J
Nº 11

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LIBRAZHD**
**KRYETARI**

**PROJEKT-VENDIM**

**NR_____, Datë __/___/2026**

**"PËR MIRATIMIN E LISTËS SHTESË TË FAMILJEVE QË PLOTËSOJNË KUSHTET PËR PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR VITIN 2026"**

Bazuar në Ligjin nr.22/2018, "Për strehimin social", Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", VKM Nr.459, date 03.07.2019 " Rregulla për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyren e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë pergjegjëse për strehimin ",V.K.B nr.98, datë 28.10.2025 "Mbi miratimin e sistemit të pikezimit për programet e strehimit"

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e listës emërore shtesë të familjeve që do të përfitojnë subvecionim qiraje për vitin 2026.
2. Miratimin në parim të financimit në masën 100 % nga Bashkia Librazhd.
3. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Kontrollit të Territorit dhe Pronës, dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.
4. Ky vendimi hyn në fuqi 10 (dhjete) ditë pas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6 e ligjit nr. 139/2015 "Për veteqeverisjen vendore" si dhe pas shprehjes se ligjshmerisë nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Mariglen Disha**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LIBRAZHD**
**KRYETARI**

# RELACION
## "PËR MIRATIMIN E LISTËS SHTESË TË FAMILJEVE QË PLOTESOJNË KUSHTET PER PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të:

-Ligjit 139/2015 datë17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2
-Ligjit nr.22/2018, "Për Strehimin Social" I ndryshuar, të neneve 3, 4, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji,
-VKM 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore",
-VKM 362, date 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij",
-VKM nr.459 datë 3.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin",
-VKM nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit",
-Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit",
-Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
-VKB Nr.98 datë 28.10.2025 "Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet e strehimit".

Referuar kërkesave të qytetarëve Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe Pronës mori në shqyrtim kërkesën e 6 aplikantëve.

Aplikanti Pandeli Xhabli i përket kategorive që favorizohen nga ligji i strehimit për përfitimin e kompensimit te qirasë, pasi kjo familje aplikuese ka këto kushte:
Burre dhe grua janë të moshuar rreth 70 vjec. Jetojnë me qera dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar qiranë e shtëpise.

Aplikanti Aishe Noni i përket kategorive që favorizohen nga ligji i strehimit për përfitimin e kompensimit të qirasë, pasi kjo familje aplikuese ka këto kushte:
Aishe 77 vjec pensioniste, jeton vetëm pasi bashkëshorti I ka ndërruar jetë .
Të ardhurat e saj janë të pa mjaftueshme për të paguar qiranë e shtëpise.

Aplikanti Fatbardha Omeri i përket kategorive që favorizohen nga ligji i strehimit për perfitimin e kompensimit te qirasë, pasi kjo familje aplikuese ka këto kushte:
Fatbardha 55 vjec e divorcuar ka në ngarkim 1 fëmijë. Gjithashtu është invalide e shkallës së 2-të. Të ardhurat e saj janë të pa mjaftueshme për të paguar qiranë e shtëpise.

Aplikanti Osman Qosja nga Njësia Administrative Qendër, fshati Dragostunjë, është rast I emergjencave civile. Shtëpia që kishin pësoi dëmtime të mëdha nga rrëshqitjet e dheut,duke detyruar familjen të lëvizë në shtëpi me qira.

Aplikanti Nadire Çepi i përket kategorive që favorizohen nga ligji i strehimit për perfitimin e kompensimit të qirasë, pasi kjo familje aplikuese ka këto kushte:
Nadire 48 vjec e divorcuar ka në ngarkim 1 fëmijë. Të ardhurat e saj janë të pa mjaftueshme për të paguar qiranë e shtëpise.

Aplikanti Mimoza Halili i përket kategorive që favorizohen nga ligji i strehimit për përfitimin e kompensimit të qirasë, pasi kjo familje aplikuese ka këto kushte:
Mimoza jeton me bashkëshortin i cili është invalid pune dhe 2 fëmijët nën moshë,gjithashtu trajtohen me ndihmë ekonomike. Jetojnë me qira dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar qiranë e shtëpise.

Për këto aplikantë kompesimi i bonusit të qirasë do të financohet 100% nga bashkia.
Bashkia Librazhd ka parashikuar në buxhet totalin prej 3,000,000 lekë në dispozicion të familjeve që do të trajtohen nga programi i bonusit të qirasë.

| Nr. | Emër/Atësi/Mbiemër | Perberje familjare | Kategoria ( sipas pikes 45, e nenit 2, te ligjit 22/2018) | Aftesia perballuese sipas nenit 3 te ligjit | Qiraja e perballueshme | subvencioni ne muaj | subvencioni ne muaj qe mbulohet nga bashkia | Subvencioni per pjesen e mbetur te vitit qe mbulohet nga bashkia |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pandeli Ismail Xhabli | 2 | familje pa të ardhura, të moshuar | 0% | 0 | 9000 | 9000 | 81000 |
| 2 | Aishe Ismail Noni | 1 | e moshuar,pa të ardhura | 0% | 0 | 7000 | 7000 | 63000 |
| 3 | Fatbardha Haziz Omeri | 2 | kryefamiljare,e divorcuar,invalide | 0% | 0 | 9000 | 9000 | 81000 |
| 4 | Osman Hysen Qosja | 3 | Emergjencat civile | 0% | 0 | 12000 | 12000 | 108000 |
| 5 | Nadire Sami Çepi | 2 | kryefamiljare,e divorcuar | 0% | 0 | 9000 | 9000 | 81000 |
| 6 | Mimoza Haki Halili | 4 | Ndihmë ekonomike | 0% | 0 | 12000 | 12000 | 108000 |
| | | | | | | | | |
| | **Totali Prill -Dhjetor 2026** | | | | | | | **522000** |

Propozojmë miratimin e listës nga Këshilli Bashkiak.

*Konc:* *M.Muça*
*Pranoi:* *A.Haskurti*

P/V
Nr. 12

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBRAZHD**
**AGJENCIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME**
**SEKTORI I MBROJTJES SË PYJEVE DHE KULLOTAVE**

# PROJEKT – VENDIM

**Nr._______, Datë____/____/2026**

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS, PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QË DO TË MERREN NË MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRET.**

# PROGRAM-PUNE

## "Për parandalimi dhe masat që do të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret"

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të Ligjit 152/2015 datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", të Ligjit nr.57 datë 30.04.2020 "Për pyjet", të Ligjit Nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" të ndryshuar, të V.K.M-së Nr. 290 datë 30.4.2004 "Për miratimin e strategjisë kombëtare dhe menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota", V.K.M-së Nr. 1080 datë 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve", të VKM-së Nr.684 datë 02.09.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave, "Për transerimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive, të ndryshuar", hartohet ky program pune **"Për parandalimin dhe masat që do të merren për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve dhe kullotave",** për territorin qe mbulon Bashkia Librazhd për vitin **2026**.

| Nr | Masat që do të merren | Afati | Zbatuesi |
|---|---|---|---|
| 1 | **Në Bashkinë Librazhd krijohet Shtabi i Mbrojtjes nga Zjarri me përbërjen e mëposhtmë :**<br>1. Gazmir BAHITI N/Kryetar i Bashkisë Kryetar<br>2. Bajram PISHKASHI Sekretar i Përgjithshëm Anëtar<br>3. Partizan BALLOLLI Shefi i Sektorit të MZSH-së Anëtar<br>4. Aleksandër BRAZHDA Përgj. Menaxhimi i Pyjeve dhe Kullotave Anetar<br>5. Bledar ÇOTA K/Inspektor Sek. Mbrojtjes së Pyjeve Anetar<br>6. Adrian KARAJ Specialis menaxhimi Anëtar<br>7. Besnik GJINI Insp. zone Anëtar<br>8. Latif QETI Insp. zone Anëtar<br>9. Roshi ÇOTA Insp.zone Anëtar<br>10. Juljan BICI Insp.zone Anëtar<br>11. Niko ALLIU Insp.zone Anëtar<br>12. Iris FAQOLLI Insp.zone Anëtar<br>13. Klodian DAJA Adm. Hotolisht Anëtar<br>14. Daut ÇOTA Adm. Orenjë Anëtar<br>15. Edvina KOÇI Adm. Polis Anëtar<br>16. Andon KODRALI Adm. Lunik Anëtar<br>17. Albert KALECI Adm. Steblevë Anëtar<br>18. Roland ÇOTA Adm. Qendër Anëtar | Deri më 31.12.2026 | Shtabi |

| Nr | MASAT QË DO TË MERREN | AFATI | ZBATUESI |
|---|---|---|---|
| 1 | • Shtabi i Mbrojtjes nga Zjarri do të ndjekë në vazhdimësi të gjitha problemet që kanë të bëjnë me masat parandaluse si dhe me masat për përballimin e situatës në rast zjarri.<br><br>• Shtabi do të mblidhet çdo fund muaji dhe në rast të shfaqjes së zjarrit menjeherë pas shuarjes së plotë të tij do të bëhet analiza dhe dëmet që janë shkaktuar nga zjarri.<br><br>• Në rast të shfaqjes së zjarrit do të funksionojë skema e lajmërimit bashkëngjitur këtij programi-pune.<br><br>• Shtabi të mbajë lidhje të vazhdueshme me inspektorët e zonave pyjore dhe administratorët e Njësive Administrative dhe këto të fundit me kryetarët e fshatrave. | **Vazhdimisht** | **Shtabi** |
| 2 | • Inspektorët e zonave së bashku me kryetarët e fshatrave të organizojnë skuadrat vullnetare për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri si dhe ripunimin e ligjit te pyjeve dhe kullotave në çdo fshat nën drejtimin e kryetarit të fshatit me 5-11 persona .<br><br>• Në këto skuadra vullnetare të ketë 1-2 persona që përdorin motorrsharrë.Para fillimit të punës do të bëhet instruktimi i të gjithë pjesmarrësve në shuarjen e zjarrit duke vënë theksin në mbrojtjen e shëndetit. | **Deri 15 maj 2026** | **Insp.zonave Kryetaret fshatit Sektori MZSH Administratoret** |
| 3 | • Për shuarjen e zjarreve do të mbahet në gadishmëri të plotë baza 4opulate e nevojshme (veglat e punës,fikset etj ) sipas invetarit përkatës. | **Vazhdimisht** | **Insp.zonave** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | • Pikat e vrojtimit në mënyrë që të mbulohet i gjithë fondi pyjor nga vrojtuesit do të jetë si mëposhtë:<br><br>❖ Në fshatin Babje në vendin e quajtur Qafa e Gajorit.<br>❖ Në fshatin Spathar në vendin e quajtur Guri i Skenderbeut.<br>❖ Në fshatin Arres në vendin e quajtur Bregu i Gjatë.<br>❖ Në fshatin Semes në vendin e quajtur Qafza.<br>❖ Në fshatin Togëz në vendin e quajtur Zgara.<br>❖ Në fshatin Polis në vendin e quajtur Qafë-Dardhë.<br>❖ Në fshatin Dardhë në vendin e quajtur Bace.<br>❖ Në fshatin Xhyrë në vendin e quajtur Qafa e Lesmit.<br>❖ Në Ekonominë Çermenikë në vendin e quajtur Guri i Muzhaqit.<br>❖ Në ekonominë Steblevë në vendin e quajtur Mali Zylit.<br>❖ Ne ekonomine pyjore Neshte –Prevalle ne vendin e quajtur Qafa e Prevallit.<br><br>Shënim: Kryetarët e fshatrave për çdo fshat që ata kanë nën administrim do të kenë pikat e tyre lokale të vrojtimit në bashkëpunim me banorët e fshatrave përkatës dhe do të jenë të parët që në bashkëpunim me inspektorët e zonave pyjore do të bëjnë njoftimin dhe organizimin e punës për eleminimin pasojave në rast zjarri.<br>Njoftimi do të kryhet sipas skemës përkatëse që i bashkëngjitet këtij programi pune. | **Vazhdimisht** | **Insp.zonave** |
| 5 | • Për ndjekjen në vazhdimësi të problemeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri inspektorët e zonave pyjore të jenë në kontakt të vazhdueshëm me komunitetin lokal,për kryerjen e punës sensibilizuese,parandaluese,dhe në rast zjarri marrjen e masave të menjëhershme. | **Vazhdimisht** | **Insp.zonave** |
| 6 | • Për çdo rast të shfaqies së zjarrit do të bëhet analizë e veçantë dhe do të dilet me propozime konkrete. | **Vazhdimisht** | **Shtabi** |
| 7 | • Të ndiqen në vazhdimësi plotësimi i nevojave me bazë materiale për fikjen e zjarreve. | **Vazhdimisht** | **Shtabi** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 8 | • Sigurimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me institucione të tjera duke siguruar numrat e telefonave të personave të ngarkuar sipas dhenave specifike të secilit institucion.<br>❖ Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. M.Z.SH<br>❖ Inspektoriati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit IKMT<br>❖ Njesitë Administrative të Bashkisë Librazhd/Kryetaret e fshatrave.<br>❖ Emergjencat Civile<br>❖ N/Prefekturen Librazhd<br>❖ Policine | **Vazhdimisht** | **Shtabi** |
| 9 | • Pasqyrimi në dokumentat kadastralë i dëmeve e pasojave në rast zjarresh, në bazë të evidencave të përgatitura për Drejtorinë e Pyjeve dhe M.Z.SH. | **Vazhdimisht** | **Përsonat pergjegjës** |
| 10 | • Masat propagandistike për sensibilizimin e popullatës për rrezikshmërinë dhe pasojat që sjellin zjarret në pyje dhe kullota,pasojat në mjedis etj. ( informacione, parrullave, afisheve, medjave lokale, me barijtë, nxënësit e shkollave). | **Vazhdimisht** | **Shtabi** |
| 11 | • Bashkëpunimi me subjektet e ndryshme (persona fizikë e juridikë) që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor/kullosor, për aktivizimin e burimeve njerëzore dhe materiale në rast zjarresh. | **Vazhdimisht** | **Inspektorët e zonave pyjore** |

## SHTABI I MBROJTJES SË PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI

**(Numrat e Telefonit për komunikim në rast Zjarri)**

| Nr | EMËR | MBIEMËR | NUMRI I TELEFONIT |
|---|---|---|---|
| 1 | Gazmir | Bahiti | **069 538 0686** |
| 2 | Bajram | Pishkashi | **068 200 5100** |
| 3 | Partizan | Ballolli | **068 239 3465** |
| 4 | Aleksandër | Brazhda | **068 552 2154** |
| 5 | Bledar | Çota | **069 941 9306** |
| 6 | Adrian | Karaj | **069 661 6594** |
| 7 | Besnik | Gjini | **069 278 8485** |
| 8 | Latif | Qeti | **068 538 8399** |
| 9 | Roshi | Çota | **069 514 7199** |
| 10 | Juljan | Bici | **069 666 6326** |
| 11 | Niko | Alliu | **068 803 0452** |
| 12 | Iris | Faqolli | **069 569 6768** |
| 13 | Albert | Kaleci | **067 430 6495** |
| 14 | Andon | Kodraliu | **068 385 4187** |
| 15 | Roland | Çota | **069 444 2014** |
| 16 | Edvina | Koçi | **069 887 0181** |
| 17 | Daut | Çota | **068 529 2198** |
| 18 | Klodian | Daja | **069 883 4342** |

## P/DREJTORIA E FUNKSIONEVE TË PATRANSFERUESHME

Sektori Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave
K/Inspektori
Ing. Bledar Çota

**DREJTORI**
Elona Koçi

# SKEMA E LAJMËRIMIT NË RAST ZJARRI



P/V
Nº 13

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK BUJQESISE DHE TURIZMIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE

**P/VENDIM**

**Nr. _______, datë _______/______/2026**

**PËR NJË NDRYSHIM TË VKB Nr.10 datë 30.01.20206 "PËR MIRATIMIN, SHTESA TË LISTËS SË NGASTRAVE KU DO TË LEJOHET KULLOTJA DHE KOSITJA E BARIT PËR VITIN 2026"**

Mbështetur në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",neni 54 pika f, ligjin nr.9693,datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor" i ndryshua me Ligjin 9996 datë 22.09.2008 "Për disa ndryshime në ligjin Nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor",VKM nr.433 datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike,sipas listës së inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar".
VKM nr.632,datë 11.07.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje" i ndryshuar me VKM nr. 467 datë 31.07.2025 "Miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe Livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore , shëndetësore, sportive, e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme", Udhëzimit nr.2 datë 20.07.2016, " Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe livadheve dhe proçedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari",kreu II pika 2, Këshilli i Bashkisë Librazhd i mbledhur sot më datë ______/______/ 2026, pasi dëgjoi relacionin e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik Bujqësisë dhe Turizmit.

**VENDOSI :**

1.Të miratojë shtesen e ngastrave ku do të lejohet kullotja e kositja e barit për vitin 2026 si më poshtë :

| Nr. | Qarku | Bashkia | Ekonomia Pyjore/Kullosore | Ng./ nëng | Sip. ha | Kategoria përdorimit të territorit | Të imta dhen/Dhi | Të trasha | Koeficenti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Elbasan | Librazhd | EP Vehçan | 100a | 48.76 | Pyje që Kulloten | 48 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | EP Vehçan | 100b | 9.72 | Pyje që Kulloten | 29 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | EP Vehçan | 101a | 62.75 | Pyje që Kulloten | 186 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | Librahd | 142a | 23.93 | Pyje që Kulloten | 71 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | Librahd | 144a | 7.67 | Pyje që Kulloten | 23 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | Librahd | 147a | 42.14 | Pyje që Kulloten | 126 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | Librahd | 149a | 50.14 | Pyje që Kulloten | 150 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | Librahd | 160a | 13 | Pyje që Kulloten | 39 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | Çermenikë | 106a | 16 | Pyje që Kulloten | 48 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | Çermenikë | 106c | 41.5 | Pyje që Kulloten | 123 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | Çermenikë | 107a | 23 | Pyje që Kulloten | 69 | 0 | 3 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Elbasan | Librazhd | Çermenikë | 107b | 13 | Pyje që Kulloten | 39 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | Çermenikë | 108a | 21.5 | Pyje që Kulloten | 63 | 0 | 3 |
| | Elbasan | Librazhd | Çermenikë | 108b | 33 | Pyje që Kulloten | 9 | 0 | 3 |
| **TOTALI** | | | | | **406** | | **1023** | | |

2. Proçedurat e mëtejshme ligjore do të ndiqen nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqesise dhe Turizmit të Bashkisë Librazhd.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

KONCEPTOI:
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqësisë dhe Turizmit

Përgjegjësi Menaxhimit
Ing. Aleksandër BRAZHDA

DREJTORI
Hysni Hoxha

**KRYETARI I BASHKISË**
**Mariglen Disha**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA LIBRAZHD**
**DREJRORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK BUJQESISE DHE TURIZMIT**

**<u>RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN</u>**

## PËR NJË NDRYSHIM TË VKB Nr.10 datë 30.01.20206 "PËR MIRATIMIN, SHTESA TË LISTËS SË NGASTRAVE KU DO TË LEJOHET KULLOTJA DHE KOSITJA E BARIT PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të ligjit nr.9693,datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor" i ndryshuar,nenit 15 (përdorimi për kullotje),pikat 1,2,3,4,5 dhe 6,nenit 17 (përdorimi i sipërfaqes dhe tokës) , ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet" date: 30.04.2020, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632,datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje", i ndryshuar me VKM nr. 467 datë 31.07.2025 "Miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe Livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore , shëndetësore, sportive, e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme" si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.2, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari",kreu i II-të ,pika 1,2 Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqesise dhe Turizmit sqaron si më poshtë :

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433,datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike,sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", i ndryshuar", dhe kanë kaluar në përdorim një sipërfaqe prej **9433.7 ha** kullotë.

Në muajin Mars të cdo viti Sektori I Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave mbledh dhe administron kërkesat e fermerëve që duan sipërfaqe në përdorim me afat 1-vjecar për kullotjen e bagëtive.

*Bazuar në këto kërkesa të reja nga fermerët* të cilët kërkojnë sipërfaqe për kullotje të blegtorisë u konstatua se këto sipërfaqe nuk janë të miratuara në venimin Nr.10 datë 31.01.2026 . në mënyrë që të përfshijmë këto fermerë në lidhjen e konjtratave për kullotje po kërkojmë ndryshimin e VKB-s duke shtuar sipërfaqe për kulltoje në zoant e kërkuara nga fermerët.

Në këto sipërfaqe janë përfshirë disa ngastra të ekonomive pyjore me formë përdorimi pyll, "pyje që kulloten, djerr" me siperfaqe prej 406 ha me nje kapacitet 1023 krerë, të cilat janë në afërsi të fshatrave ku mund të jepen me qira sipas kërkesave të fermerëve me afat 1-vjet.

**Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit Bashkiak të miratojë "Shtesën e Listës së ngastrave të kullotave e livadheve të gatëshme për kullotje e kositje bari për vitin 2026" në mënyrë që Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqesise dhe Turizmit të vazhdojë procedurat e mëtejshme për dhënie me qera të kullotave e livadheve.**

Jemi në pritje të miratimit nga ana J'uaj.

**Përgjegjësi i Menaxhimit**

**Ing. Aleksandër BRAZHDA**

**DREJTORI**

**Hysni Hoxha**

P/U
Nº 14

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

**PROJEKT- VENDIM**

**Nr._____ dt.__.03.2026**

**PROPOZIM PER DHENIEN NE PERDORIM TE HAPESIRES PUBLIKE**

Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9 , pika 1/1.1,shkronjar "a"dhe "b", nenit 23, pika 14 dhe nenit 64,shkronja "a" të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 për "Veteqeverisjen vendore";Ligjit Nr.44/2015, datë 17.12.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikes së Shqiperisë"; nenit 4/1 të Ligjit nr.107/2017, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe zhvillimin e territorit"(i ndryshuar); Ligjit nr.8224 datë 15.05.1997 për 'Organizimin dhe funksionimin e policisë së Bashkisë dhe Komunës" (i ndryshuar); nenit 10,11,15 dhe 17 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1096, datë 28.12.2015 per "Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike" Keshilli i Bashkise i mbledhur ne date ____.03.2026 me propozim te Kryetarit te Bashkise te :

**VENDOSI :**

1. Miratimin e dhënies ne perdorim te hapesires publike te identifikuar me numër A siperfaqe 8 m2, afat 1 vjecar me veprimtari aktivitet tregtar (kioskë) sipas planrilevimit bashkengjitur.

2. Tarifa dysheme i detyrimit mujor te jete 100 leke/m2.

3. Autorizimin e Kryetarit te Bashkise per te kryer procedurat perkatese te parashikuara ne ligj per neshkrimin e kontrates;

4. Ndjek zbatimin e ketij vendimi administrata e Bashkise Librazhd.

5. Ky vendim hyn ne fuqi 10(dhjete) dite pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË**
**MARIGLEN DISHA**

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

**PRONARI:** BASHKIA LIBRAZHD | **DATE :** 24.03.2026 | **QELLIMI:** IDENTIFIKIM PASURIE / QERA

## VENDNDODHJA

BASHKIA LIBRAZHD (Q: Librazhd) | DVASHK/ZVASHK: ELBASAN | ZONA KADASTRALE: 2446 | NUMRI PASURISE: A | V. xx FQ. xxx

## TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: TRUALL | SIPERFAQA TOTALE E PASURISE: S = 8 m² | INDEX HARTE: (F-3)

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE




**SHPJEGUESE**

Kerkohet per QERA/SHFRYTEZIM pasuria "A" , e llojit TRUALL me pronar "BASHKIA LIBRAZHD" .

- Siperfaqe Totale S= 9 m²

**Vendodhja e Pasurise A sipas sistemit KRGJSH:**

1. X = 526485.393 Y = 4560411.217

SH 1:250

| Nr. | ORIENTIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT |
|---|---|---|---|---|
| 1 | V: | | | |
| 2 | L: | | | |
| 3 | J: | | | |
| 4 | P: | | | |

**SHENIME TE REALIZUESIT**

Pasuria "A", me adrese: Rruga Iliria 01380033, Lagja Nr 1, Qyteti Librazhd, ZK. 2446, me sipërfaqe S= 8 m², e cila tregohet në hartë me kontur me vijë të kuqe.

- Kjo siperfaqe kerkohet Bashkise Librazhd per marrje me Qera, shfrytezim hapesire publike.

**REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT**

EMRI / MBIEMRI - **ING. EMILJAN GJURA**
LIÇENSA NR **T.1226/1** dt. **06.05.2022**
NIPTI: **M27926601A**

NËNSHKRIMI:

VULA:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE T - O - G

KODE PER TEKNOLOGJIINE E MATJEVE T-TERREN, Z-ZYRE, O-0RTOFOTO, G-GSP, S-STACIONTOTAL D-MATJE DISTANCASH

PERCAKTIMI I KUFIRIT P- PB PERFAQESUESE BASHKIE

KODET PERCAKTIMIN E KUFIRIT: P-PERFAQESUES I PRONAVE, K-KUFITARE TE GJITHE, KP-KUFITARE PJESERISHT PB-PERFAQESUES BASHKIE, HK- HARTE KADASTRALE

KONFIRMOI:
KRYETARI I BASHKISE
Mariglen Disha

SHENIME TE VEÇANTA

PASI U KRYEN MATJET NE TERREN, ME KERKESE TE Z. KLAUS BLLOSHMI U HARTUA KY PLAN-RILEVIM PER PASURINE "A" PER APLIKIM NE BASHKINE LIBRAZHD PER QERA/ ZHVILLIM.

EMRI: KLAUS BLLOSHMI

NENSHKRIMI: ______________

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA LIBRAZHD

ING. EMILJAN GJURA

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: BASHKIA LIBRAZHD | DATE : 24.03.2026 | QELLIMI: IDENTIFIKIM PASURIE / QERA

## VENDNDODHJA

BASHKIA LIBRAZHD (Q: Librazhd) DVASHK/ZVASHK: ELBASAN ZONA KADASTRALE: 2446 NUMRI PASURISE: A V. xx FQ. xxx

## TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: TRUALL SIPERFAQA TOTALE E PASURISE: S = 8 m² INDEX HARTE: (F-3))

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE




**SHPJEGUESE**

Kerkohet per QERA/SHFRYTEZIM pasuria "A" , e llojit TRUALL me pronar "BASHKIA LIBRAZHD" .

- Siperfaqe Totale S= 8 m$^2$

**Vendodhja e Pasurise A sipas sistemit KRGJSH:**

1. X = 526485.393 Y = 4560411.217

SH 1:500

| Nr. | ORIENTIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT |
|---|---|---|---|---|
| 1 | V: | | | |
| 2 | L: | | | |
| 3 | J: | | | |
| 4 | P: | | | |

**SHENIME TE REALIZUESIT**

Pasuria "A", me adrese: Rruga Iliria 01380033, Lagja Nr 1, Qyteti Librazhd, ZK. 2446, me sipërfaqe S= 8 m², e cila tregohet në hartë me kontur me vijë të kuqe.

- Kjo siperfaqe kerkohet Bashkise Librazhd per marrje me Qera, shfrytezim hapesire publike.

**REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT**

EMRI / MBIEMRI - **ING. EMILJAN GJURA**

LIÇENSA NR **T.1226/1** dt. **06.05.2022**

NIPTI: **M27926601A**

NËNSHKRIMI:

VULA:

KONFIRMOI:

KRYETARI I BASHKISE

Mariglen Disha

TEKNOLOGJIA E MATJEVE T - O - G

KODE PER TEKNOLOGJIINE E MATJEVE T-TERREN, Z-ZYRE, O-0RTOFOTO, G-GSP, S-STACIONTOTAL D-MATJE DISTANCASH

PERCAKTIMI I KUFIRIT P- PB PERFAQESUESE BASHKIE

KODET PERCAKTIMIN E KUFIRIT: P-PERFAQESUES I PRONAVE, K-KUFITARE TE GJITHE, KP-KUFITARE PJESERISHT PB-PERFAQESUES BASHKIE, HK- HARTE KADASTRALE

SHENIME TE VEÇANTA

PASI U KRYEN MATJET NE TERREN, ME KERKESE TE Z. KLAUS BLLOSHMI U HARTUA KY PLAN-RILEVIM PER PASURINE "A" PER APLIKIM NE BASHKINE LIBRAZHD PER QERA/ ZHVILLIM.

EMRI: KLAUS BLLOSHMI

NENSHKRIMI: ______________